


DITARI MUJOR MARS 2026

SHqipëria në ITB Berlin 2026 si një destinacion turistik në rritje në Europë

Shqipëria u prezantua në ITB Berlin 2026, panairin më të madh global të turizmit, me konceptin “Albania All Senses”, duke riafirmuar pozicionin e saj si një nga destinacionet më dinamike në rritje në Europë. Bashkëpunimi me Agjencinë Kombëtare të Turizmit, 30 tur-operatorët dhe bashkitë kryesore të vendit, solli në vëmendjen e partnerëve ndërkombëtarë një ofertë të strukturuar që thekson përvojat autentike, turizmin e qëndrueshëm dhe diversifikimin sezonal. Një risi e veçantë ishte dhe rrjeti WiFi i brand-uar “Albania All Senses”, i cili ofroi akses për mbi 100 mijë pjesëmarrës dhe orientoi vizitorët drejt stendës



shqiptare. Në kuadër të panairit, Shqipëria mori pjesë gjithashtu në Ministerialin e Turizmit të organizuar nga UN Tourism, ku riafirmoi angazhimin për zhvillim të qëndrueshëm dhe forcim të bashkëpunimeve ndërkombëtare, duke konsoliduar më tej imazhin e saj si një destinacion serioz dhe në zhvillim të qëndrueshëm

FORCOHEN LIDHJET KULTURORE DHE AKADEMIKE ME UNIVERSITETIN E ARTEVE NË BERLIN



Në kuadër të vizitës në ITB Berlin 2026, delegacioni shqiptar zhvilloi një takim në Universitetin e Arteve në Berlin, ku u prit nga Presidenti Prof. Dr. Markus Hilgert dhe Dekani i Kolegjit të Arteve të Bukura, Prof. Dr. Jörg Heiser, së bashku me stafin akademik. Takimi shërbeu për shkëmbimin e eksperiencave dhe diskutimin e mundësive për bashkëpunim në fushën e artit dhe edukimit artistik, duke forcuar dialogun ndërinstytucional. Aktiviteti u shoqërua edhe me një moment artistik nga pianistja Tabea Streicher, fituese e Konkursit “Felix Mendelssohn”, duke reflektuar frymën e bashkëpunimit dhe potencialin për projekte të përbashkëta në të ardhmen.

DELVINA SHPALLET ANSAMBËL ARKITEKTONIK URBAN, PJESË E TRASHËGIMISË KULTURORE KOMBËTARE


Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale shpalli qytetin e Delvinës pasuri kulturore të paluajtshme në kategorinë “Ansambël Arkitektonik Urban”, duke vlerësuar rëndësinë e veçantë historike, arkitektonike dhe urbanistike të këtij qyteti. Ky vendim synon mbrojtjen, ruajtjen dhe konservimin e trashëgimisë kulturore, si dhe promovimin e saj si një aset i rëndësishëm kombëtar. Përmes këtij statusi pritet gjithashtu të nxitet zhvillimi i turizmit kulturor, të inkurajohen ndërhyrjet restauruese dhe të rritet ndërgjegjësimi publik mbi vlerat e trashëgimisë kulturore dhe identitetit historik të Delvinës.



LINI SHPALLET ANSAMBËL ARKITEKTONIK URBAN, NJË THESAR I MBROJTUR I TRASHËGIMISË KULTURORE

Fshati piktoresk i Linit në Pogradec u shpall pasuri kulturore e paluajtshme në kategorinë “Ansambël Arkitektonik Urban” me vendim të Këshillit të Ministrave, duke u vlerësuar si një nga thesaret më të rralla të trashëgimisë sonë kulturore.

Ky vendim synon mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave të tij unike historike dhe arkitektonike, si dhe garanton restaurimin dhe administrimin e qëndrueshëm të zonës, përmes përcaktimit të qartë të zonës mbrojtëse, rregullave dhe përgjegjësive institucionale. Në këtë mënyrë, sigurohet që Lini të ruhet dhe të trashëgohet ndër breza, duke forcuar njëkohësisht potencialin e tij si destinacion i rëndësishëm i turizmit kulturor.



ASAMBLEJA E 32-TË E KOKSH: RRRITET MBËSHTETJA FINANCIARE DHE ZHVILLIMI I SPORTIT NË VEND



Në Asamblenë e Përgjithshme të 32-të të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, u prezantua mbështetja financiare për vitin 2026, me rreth 185.5 milion lekë për 18 federata olimpike dhe 45.2 milion lekë për 16 federata jo-olimpike, si dhe financime për projekte strategjike dhe zhvillimin e sportit gjithëpërfshirës.

Paralelisht, programi “Ekipet Sportive në Shkolla” është zgjeruar ndjeshëm, duke përfshirë rreth 11,000 nxënës në 293 shkolla, me 826 ekipe dhe 430 trajnerë. Investimet në infrastrukturë dhe organizimi i eventeve ndërkombëtare vijojnë të forcojnë bazat për një zhvillim të qëndrueshëm dhe rezultate afatgjata të sportit shqiptar.

MBAHET “MATCHMAKER ALBANIA”, PLATFORMA KYÇE PËR INVESTIME DHE BASHKËPUNIM EKONOMIK

Për të dytin vit radhazi, MatchMaker Albania vjen si një platformë e rëndësishme për nxitjen e investimeve dhe forcimin e bashkëpunimit ekonomik, duke bashkuar mbi 1000 pjesëmarrës dhe duke mundësuar më shumë se 400 takime mes investitorëve, kompanive dhe institucioneve vendase e ndërkombëtare. Aktiviteti u zhvillua me mbështetjen e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe nën kujdesin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve. Në këtë kuadër, u riafirmua angazhimi për orientimin e zhvillimit të turizmit drejt investimeve cilësore dhe të qëndrueshme, duke forcuar bashkëpunimin me partnerët strategjikë dhe sektorin privat, me synim rritjen e konkurrueshmërisë së Shqipërisë në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.



BASHKËPUNIMI ME BANKËN BOTËRORE PËR INVESTIME STRATEGJIKE NË TURIZËM DHE TRASHËGIMI KULTURORE

Në vijim të dialogut të nisur, Ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Blendi Gonxhja, zhvilloi takimin e dytë me përfaqësuesit e Grupit të Bankës Botërore, në prani të Drejtueses së Divizionit për Ballkanin Perëndimor, Xiaoqing Yu, duke avancuar diskutimet për krijimin e një instrumenti financiar në mbështetje të investimeve strategjike në turizëm dhe trashëgimi kulturore. Takimi pasoi një seri diskutimesh teknike me institucionet partnere, ku u trajtuan hapat konkretë drejt marrëveshjes së re të financimit, projektet prioritare dhe nisja e fazës së “feasibility study”, e mbështetur nga një grant prej 3 milionë dollarësh (GFPP). Ky bashkëpunim synon të



modelet e financimit dhe cilësinë e ndërhyrjeve në sektor, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe promovimin e identitetit kulturor e natyror të vendit, me fokus edhe në zona prioritare si Vorë dhe Pogradec.

NGA TURIZMI TE INFRASTRUKTURA: SHQIPËRIA DREJT NJË FAZE TË RE INVESTIMESH NDËRKOMBËTARE NË MIPIM 2026



Shqipëria mori pjesë në MIPIM 2026 në Cannes, një nga platformat më të rëndësishme globale për zhvillimin dhe investimet në pasuri të paluajtshme, duke prezantuar një portofol prej 83 projektsh strategjike të lidhura me turizmin, infrastrukturën dhe zhvillimin e territorit. Përmes pavijonit “Soundscapes of Albania”, delegacioni shqiptar ndau me partnerë dhe investitorë ndërkombëtarë potencialin turistik dhe vizionin për një turizëm cilësor, të qëndrueshëm dhe gjithëvjeter. Pjesëmarrja në këtë platformë, ku përfaqësohen aktorë me mbi 4 trilionë euro asete, shërbeu për të forcuar dialogun dhe për të konsoliduar partneritetet ndërkombëtare, duke rritur më tej profilin e Shqipërisë si një destinacion tërheqës për investime afatgjata dhe zhvillim të qëndrueshëm.

KOORDINIM INSTITUCIONAL PËR VLORËN: PËRGATITJE PËR SEZONIN TURISTIK DHE ADRESIM I PRIORITETEVE KRYESORE

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, nisi punën për adresimin e disa prej problematikave prioritare, duke ngritur grupe të përbashkëta pune për verifikimin e nevojave dhe mundësive për vende ankorimi, si dhe për koordinimin e projekteve në zhvillim dhe përgatitjet për një sezon turistik të shtrirë përtej verës. Fokus i veçantë iu kushtua menaxhimit dhe pastrimit të plazheve, përgatitjes së vijës bregdetare dhe rritjes së standardeve për qytetarët dhe turistët, si dhe avancimit të investimeve në proces, përfshirë ndërhyrjet në Kalanë e Kaninës dhe bashkëmenaxhimin e aseteve kulturore. Ky angazhim synon forcimin e sinergjisë mes turizmit, kulturës dhe sportit, për një sezon më të organizuar dhe një zhvillim më të qëndrueshëm të qytetit të Vlorës.



ZGJEROHET HARTA ARKEOLOGJIKE E SHKODRËS ME SITIN E RI NË BUSHAT



Harta arkeologjike e rajonit të Shkodrës u pasurua me një sit të ri në Bushat, për të cilin Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale miratoi zonifikimin dhe rregulloren për ruajtjen dhe administrimin e zonës “A” arkeologjike. Gërmimet, të nisura që në vitin 2018 nga misioni shqiptaro-polak, po zbulojnë të dhëna të rëndësishme mbi këtë qendër ilire, ku deri më tani janë identifikuar dy porta hyrëse që ndihmojnë në përcaktimin e shtrirjes së qytetit. Punimet më të fundit janë përqendruar në qytetin e sipërm, duke hedhur dritë mbi organizimin e brendshëm dhe urbanistikën, ndërsa rezultatet paraprake tregojnë për një ndërtim masiv që daton që në gjysmën e shekullit IV p.e.s.

EDUKIMI PËRMES KULTURËS DHE AKTIVITETEVE PAS SHKOLLORE NË FOKUS TË ZHVILLIMIT TË TË RINJVE

U mbajt Konferenca mbarëkombëtare për Edukimin pas shkollor, ku përfaqësues të institucioneve diskutuan mbi rolin e aktiviteteve jashtëkurrikulare në zhvillimin gjithëpërfshirës të nxënësve, me theks të veçantë të formimi kulturor dhe zhvillimi i aftësive të reja tek fëmijët dhe të rinjtë. Investimi në art, kulturë dhe sport u riafirmua si prioritet strategjik kombëtar, i lidhur drejtpërdrejt me cilësinë e arsimit dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor. Vetëm në periudhën janar–shkurt 2026, përmes programit “Edukimi përmes Kulturës” u organizuan 78 aktivitete me mbi 3500 pjesëmarrës, ndërsa programet e Qendrës



Kulturore për Fëmijë dhe përfshirja në Korin e Zërave të Bardhë të TKOBAP-së ofrojnë modele konkrete të edukimit artistik cilësor. Këto angazhime plotësohen edhe nga iniciativa si Catalyst, që sjell trajnime të specializuara sipas standardeve ndërkombëtare, ndërkohë që shumë shpejt pritet të vihet në funksion një godinë e re për Qendrën Kulturore për Fëmijë, duke rritur më tej aksesin dhe cilësinë e aktiviteteve kulturore për të rinjtë në të gjithë vendin.

MBAHET TAKIMI ME AADF MBI REZULTATET POZITIVE DHE ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË BUTRINTIT

Gjatë mbledhjes së bordit me përfaqësues të AADF dhe BMF për Parkun Arkeologjik të Butrintit, u vlerësua ecuria shumë pozitive e vitit të kaluar, duke theksuar mirëmenaxhimin dhe administrimin efikas të këtij siti të rëndësishëm kulturor. Numri i vizitorëve arriti në 295,152, ose 147% më shumë krahasuar me vitin 2023, ndërsa të ardhurat u rritën me 218%, duke reflektuar një performancë të qëndrueshme dhe në rritje. Në vijim, u diskutuan pritshmëritë për sezonin e ri turistik dhe nevoja për pasurimin e kalendarit të aktiviteteve kulturore, me synim përmirësimin e mëtejshëm të eksperiencës së vizitorëve në Butrint.



SHQIPËRIA PREZANTOHET NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR TË LIBRIT NË LEIPZIG

Në fillim të muajit, Shqipëria u përfaqësua në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Leipzig përmes Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, duke krijuar një hapësirë të rëndësishme për promovimin e letërsisë dhe kulturës shqiptare. Gjatë ditëve të panairit, stenda shqiptare mirëpriti një numër të konsiderueshëm vizitorësh, vendas dhe ndërkombëtarë, duke nxitur interes në rritje për krijimtarinë shqipe. Përmes autorëve, botimeve



të përzgjedhura dhe aktiviteteve të organizuara, pjesëmarrja kontribuoi në forcimin e bashkëpunimit kulturor dhe në prezantimin dinjitoz të Shqipërisë në një nga ngjarjet më të rëndësishme të librit në Europë.

1177 APLIKIME PËR STACIONET E PLAZHIT 2026 KALOJNË SHQYRTIMIN PARAPRAK

Me 1177 aplikime të paraqitura, procesi i aplikimeve për stacionet e plazhit për sezonin 2026, i zhvilluar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, ka kaluar fazën e shqyrtimit paraprak. Subjektet janë njoftuar për statusin e tyre përmes platformës e-Albania dhe pritet të ndjekin hapat përkatës për vijimin e procedurave. Plotësimi në



kohë i dokumentacionit mbetet thelbësor për përmbylljen e procesit dhe garantimin e një sezoni veror të rregullt, të organizuar dhe të sigurt për qytetarët dhe turistët.



RRITET NDJESHËM INTERESI PËR TRASHËGIMINË KULTURORE NË FILLIM TË VITIT 2026

Gjatë dy muajve të parë të vitit 2026, trashëgimia kulturore e Shqipërisë ka tërhequr 42,251 vizitorë vendas dhe të huaj, duke reflektuar një rritje të qëndrueshme të interesit për historinë dhe pasuritë kulturore të vendit. Nga këta, 21,134 vizitorë kanë frekuentuar Muzetë Kombëtare, 14,394 Parqet Arkeologjike dhe 6,723 Kalatë dhe Monumentet e Kulturës.

Ndër sitet më të vizituara spikasin Parku Arkeologjik i Shkodrës, Muzeu Kombëtar "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" dhe Kalaja e Gjirokastrës, duke konfirmuar rolin gjithnjë në rritje të turizmit kulturor si një shtyllë e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në vend.

ZBULOHEK VENDBANIMI I RI ARKEOLOGJIK NË ZONËN E LUSHNJËS.

Arkeologët e IKTK-së, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnje, po kryejnë gërmime arkeologjike shpëtimi në vendin e quajtur Kodra e Pusit, pranë fshatit Murizë-Peqin.

Gërmimet kanë zbuluar gjurmët e një vendbanimi të rëndësishëm me kohështrirje nga periudha romake deri në antikitetin e vonë. Hulumtimet do të vijojnë për të pasuruar njohuritë mbi historinë dhe zhvillimin e kësaj zone.



VIJOJNË PUNIMET NË KALANË E KANINËS PËR PËRMIRËSIMIN E EKSPERIENCËS SË VIZITORËVE

Në vijim të investimeve në trashëgiminë kulturore, po vijojnë me ritme të mira ndërhyrjet konservuese, strukturale dhe gjeologjike në Kalanë e Kaninës në Vlorë, në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe CHwB Albania.

Ndërhyrjet synojnë jo vetëm konsolidimin dhe ruajtjen e strukturave historike të kalasë, por edhe zhvillimin e saj si një destinacion i rëndësishëm kulturor dhe turistik për qytetin e Vlorës. Projekti përfshin gjithashtu hartimin e planeve të interpretimit dhe përmirësimin e eksperiencës për vizitorët, duke synuar rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe aksesit.

